

Dr. Tony B. Watlington Sr., Ed.D.
Superintendent

I nderuar Komunitet i Drejtorise Arsimore të Filadelfias,

Në dritën e ngjarjeve të fundit, unë po ndaj me ju këtë mesazh sot për të riafirmuar angazhimin e Drejtorisë Arsimore të Filadelfias për të krijuar hapësira të sigurta, mikpritëse për studentët dhe familjet tona, në përputhje me Kushtetutën e SHBA-së, ligjin e shtetit të Pensilvanisë dhe në frymën e “ Board of Education’s Welcoming Sanctuary Schools Resolution “ Kjo përfshin të gjithë studentët, pa marrë parasysh racën, përkatësinë etnike, statusin e imigracionit, origjinën kombëtare, identitetin, shprehjen gjinore, orientimin seksual, statusin familjar, fenë ose aftësitë e personit. Drejtoria do të jetë në përputhje me ligjet e kërkuara, dhe drejtuesve të shkollave u janë dhënë udhëzime se si të mbrojnë të drejtat e studentëve tanë emigrantë.

Çfarë duhet të dinë studentët dhe familjet:

- Ju lutemi sigurohuni që të gjitha informacionet e kontaktit të urgjencës të përditësohen për studentin tuaj. Për të përditësuar informacionin tuaj të kontaktit, kontaktoni shkollën e fëmijës suaj.
- Punonjësve, vullnetarëve dhe kontraktorëve të drejtorisë u ndalohet të pyesin ose ndajnë çdo informacion personal rreth studentëve ose familjeve tuaja, duke përfshirë statusin e emigracionit, përveç rasteve kur kërkohet me ligj dhe autorizohet nga Zyra e Këshillit të Përgjithshëm të Drejtorisë.
- Ne u dhamë udhëzime drejtuesve të shkollave se si të trajtojnë çdo kërkesë të mundshme nga zyrtarët e imigracionit.

Nëse keni pyetje ose shqetësime, ju lutemi na kontaktoni duke përdorur platformën tonë të komunikimit të dyanshëm, [Let’s Talk](#) / [Le të Bisedojmë](#). Ne do të vazhdojmë të punojmë për të ofruar informacion kuptimplotë dhe trajnim të fuqishëm për personelin e shkollës dhe të drejtorisë për të nxitur mjedise të sigurta dhe mikpritëse ku të gjithë studentët tanë mund të mësojnë dhe të arrijnë suksese.

Në partneritet,



Tony B. Watlington Sr., Ed.D.
Superintendent
Drejtoria Arsimore e Filadelfias